



Nr. 6904/ Prot
Dt. 20.11.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.722/1prot.

Shkodër, më/ j. 11.2023

LËNDA: Mbi vendimin Nr.81, datë 30.10.2023 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 24, neni 54/n, neni 15, neni 16 i ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, shkresës Nr.6895prot, datë 3.11.2023 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës të datës 30.10.2023", analizoi **VKB Vau-Dejës Nr.81, datë 30.10.2023** "Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2023, konkretisht për programin "Subvencioni i qerasë në tregun e lirë dhe përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme".


Pas trajtimit, lejohet procedim i mëtejshëm, duke sjellë në vëmendje zbatimin e nenit 15 të ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar me ligjin nr.48/2023, në të cilin shprehet se njësitë e qeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit për çdo vitështë shfuqizuar".

Për sa trajtuar, të mbahet në vëmendje gjatë zbatimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

PREFEKTI

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK
VENDIM**

Nr. 81 datë 30.10. 2023

**PER MIRATIMIN E SISTEMEVE TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E
STREHIMIT SOCIAL PER VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma “n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar , neni 15 dhe neni 16, VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, VKM 362, datë 29.05.2019 për kriteret e dhenies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gezojnë përparsi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet bugjetit të shtetit dhe menyren e llogaritjes së tij: Të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr.33 datë 28.04.2023:

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI**

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për vitin , i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit “**Subvencioni i qiras, në tregun e lire**”
2. Miratimin e sistemit të pikëzimit, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit “**Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme**”
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian ÇELEPIJA

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me Datë 03.11.2023



KRYETAR
Ervis Shimaj